



Buletini Informativ

- * Hyrje
- * Aktivitetet e përgjithshme
 - * Veprimtaria botuese
 - * Vlerësimi i nevojave trajnuese
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)
 - * Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme (PTV)

Korrik 2020

Hyrje

Edhe gjatë muajit korrik si rezultat i rrethanave të krijuara nga pandemia COVID 19 Akademia e Drejtësisë ka vazhduar veprimtarinë e saj të dizajnuar në pajtim me masat dhe kriteret e përcaktuara për mbrojtje dhe parandalim të kësaj pandemie.

Të gjitha aktivitetet trajnuese si në trajnimet e vazhdueshme ashtu edhe në ato fillestare janë realizuar përmes platformës ZOOM.

Përveç trajnimeve, përmes kësaj platforme janë realizuar edhe një pjesë e konsiderueshme e takimeve me bashkëpunëtorë dhe donatorë të Akademisë të cilat kishin qëllim bashkëpunimin dhe koordinimin reciprok në zbatimin e aktiviteteve të përbashkëta.

Për më tepër në këtë buletin në rubrikat në vijim pasqyrohen aktivitetet e përgjithshme në dobi të zbatimit të programeve trajnuese, takimet e ndryshme, aktivitetet në dobi të vlerësimit të nevojave trajnuese si dhe aktivitetet e realizuara nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme të specifikuara sipas temës së trajnimit, kohëzgjatjes dhe përfituesve të saj dhe aktivitetet nga Programi i Trajnimeve Fillestare sipas sesioneve dhe moduleve trajnuese.

Përveç aktiviteteve të lartpërmendura, buletini përmban edhe njoftimin sa i përket kurseve trajnuese të realizuara në platformën e mësimin në distancë

Aktivitetet të përgjithshme

Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe aktivitetet e përbashkëta me donatorët dhe projektet

Në vazhden e bashkëpunimit me institucionet e sistemit të drejtësisë dhe miqtë dhe partnerët e AD-së edhe gjatë muajit korrik janë realizuar takime qoftë virtuale ashtu edhe fizike për të konkretizuar aktivitetet e asistencës në zhvillim dhe zbatim të programeve trajnuese.

Në vijim janë takimet e realizuara dhe çështjet që janë trajtuar gjatë këtyre takimeve:

AD ka zhvilluar takim me kryesuesin e KGJK -se në të cilin është diskutuar çështja e certifikimit të gjyqtareve të sapoemëruar kur dihet se korniza ligjore e zbatueshme nuk rregullon çështjen e certifikimit, por vetëm nxjerrjen e vërtetimit për vijueshmërinë e trajnimit fillestar. Përveç kësaj është shqyrtuar mundësia e dekretimit të gjyqtarëve, gjenerata e VIII-të dhe nevoja për zbatimin e programit në kohë sa më optimale.

AD dhe SHSK - Shoqata e Sigurime të Kosovës, pas disa takimeve dhe bisedave të vazhdueshme kanë nënshkruar Marrëveshjen e Bashkëpunimit me të cilën synohet ofrimi i ekspertizave dhe praktikave regjionale dhe ndërkombëtare në zbatimin e legjislacionit të sigurimeve.

Në vazhden e bashkëpunimit institucional është realizuar takimi me përfaqësuesit e Odes së Ndërmjetësuesve, ku është diskutuar mundësia e bashkëpunimit në zhvillimin dhe organizimin e trajnimeve të vazhdueshme për ndërmjetësuesit. Në muajt në vijim është akorduar nënshkrimi i një memorandumit të bashkëpunimit për formalizmin dhe avancimin e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve.

AD gjithashtu ka marr pjesë në Hartimin e Projekt Strategjisë Sektoriale të Sundimit të Ligjit në Kosovë. Në takimin e organizuar nga

Ministria e Drejtësisë është prezantuar dokumenti përmbledhës i politikave dhe masave të rekomanduara gjatë zhvillimit të grupeve punuese.

Në vazhden e bashkëpunimit me Ministrinë e Drejtësisë, është shqyrtuar mundësia e përfshirjes së profesioneve të lira në trajnimet e AD-së.

AD gjithashtu ka marrë pjesë në takimin e organizuar nga Instituti Kombëtar Demokratik i cili është mbështetur nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe në bashkëpunim me Komisionin Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, ku është diskutuar tema “Përgatitja e institucioneve përgjegjëse për zbatimin e drejtë të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës.”

Në kuadër të bashkëpunimit me përfaqësuesit e zyrës OPDAT të Ambasadës së SHBA-së janë realizuar disa takime virtuale në të cilat janë diskutuar prioritetet për AD-në si programi i trajnimit për trajner -TT, si dhe avancimi dhe fuqizimi i menaxhimit të programit të trajnimeve dhe të të mësuarit, me ç’ rast është diskutuar mundësia e pajisjes së AD-së me një softwer për menaxhim të të mësuarit.

Bashkëpunimi me projektin e USAID-t / CJA (Aktivitete në Drejtësinë Komerciale), ka vazhduar e cila është konkretizuar me nënshkrimin e marrëveshjes e cila përcakton zhvillimin e kurrikulës trajnuese për gjyqtarët dhe profesionistët e tjerë ligjorë në drejtësinë komerciale.

Në vazhden e takimeve për zhvillim dhe zbatim të programeve është edhe takimi virtual me përfaqësuesit e zyrës së Këshillit të Evropës projekti JUFREX që është tashmë duke e ndihmuar AD-në në trajnimet ndërlidhur me lirinë shprehjes.

Në kuadër të bashkëpunimit me UNDP është realizuar takimi virtual me përfaqësues të kësaj organizate për të diskutuar planin e vlerësimit të nevojave trajnuese në fushën e anti diskriminimit. Në vijim në fund të muajit korrik është zbatuar ky plan, fillimisht me takimin me fokus grupet me përqendrim te Zyra për Qeverisje të Mire, Institucioni i Ombudspersonit dhe mediat lokale i cili është realizuar me 27 korrik 2020 dhe fokus grupi i dytë me përfaqësues të ministrive dhe të komunave (Zyra për të Drejtat e njeriut dhe Zyra për barazi gjinore) i cili është realizuar

me 28 korrik 2020. Për muajin gusht është dakorduar edhe takimi me fokus grupin e gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial.

AD në vijim ka marrë pjesë në takimin e Komitetit Drejtues të projektit të Këshillit të Evropës “Forcimi i institucioneve të Kosovës në luftën kundër torturës, degradimit dhe trajtimeve tjera degraduese” e gjithashtu edhe në Konferencën HELP në të cilën është shënuar “70 vjetori i KEDNJ-së.

Nënshkruhet Memorandumi i Bashkëpunimit mes Akademisë së Drejtësisë dhe Shoqatës së Sigurimeve

Me 02 korrik 2020, Drejtori Ekzekutiv i AD-së së z. Enver Fejzullahu së bashku me znj. Luljetë Hetemi, Udhëheqëse e Programit për Hulumtime dhe Publikime si dhe znj. Melihate Rama, Udhëheqëse e Trajnimit të



Vazhdueshëm kanë zhvilluar një takim të përbashkët me z. Sami Mazreku Drejtor Ekzekutiv në Shoqatën e Sigurimeve të Kosovës si dhe z. Venhar Hana, Shef i Zyrës Ligjore dhe Administratës në Shoqatën e Sigurimeve të Kosovës.

Qëllimi i këtij takimi ishte bashkëpunimi i AD-së-së dhe Shoqatës së Sigurimeve-së në interes të ngritjes së kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve dhe sistemit gjyqësor në përgjithësi në fushën e sigurimeve.

Me rastin e këtij takimi u nënshkrua Memorandumi i Bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve për të fuqizuar edhe më tutje bashkëpunimin ndërinstitucional në sferën e trajnimeve që kanë në fokus trajtimin e kërkesave për kompensimin e dëmeve që rrjedhin nga kontratat e sigurimeve për të gjitha produktet e sigurimit të njohura sipas ligjit.

Gjatë këtij takimi përvës nënshkrimit të Memorandumi të Bashkëpunimit mes dy palëve u diskutua edhe për procesin e planeve të trajnimeve, në veçanti për të gjeturat e Shoqatës së Sigurimeve sa i përket praktikës gjyqësore në rastet e sigurimeve dhe gjithashtu edhe për ekspertizën që ata e kanë në dobi të përmirësimit të zgjidhjes së kontesteve në këtë fushë.

Në fund të takimit bashkëbiseduesit u pajtuan që të vazhdoj koordinimi dhe bashkëpunimi reciprok për funksionimin më të mirë dhe më cilësor të aktiviteteve trajnuese të përbashkëta.



Konferenca e HELP – (Rrjeti E- KONFERENCA 2020), për shënimin e 70 vjetorit të KEDNJ-së në kohëra kritike, ne Strasburg të Francës

Akademia e Drejtësisë me datën 08-09 korrik 2020 ka marr pjesë në Konferencën e (HELP-it) që është organizuar si E- KONFERENCA 2020, për shënimin e “70 vjetorit të KEDNJ-së ne kohëra kritike”, në të cilën kanë marr pjesë prokurorë dhe trajnues gjyqësor të Akademisë së Drejtësisë. Kjo konferencë është organizuar përmes PROGRAMIT TË KESHILLIT TE EVROPES PER ARSIMIMIN E TE DREJTAVE TE NJERIUT PER PROFESIONISTE LIGJORE – NE STRASBOURG.

Në këtë konferencë në ditën e parë janë trajtuar temat në vijim: HELP - Arritjet në vitin e kaluar, Kursi i Ndhmës për Hyrjen në KEDNJ dhe GJEDNJ si dhe Ekzekutimi i Vendimeve, Arritjet e HELP: Fokusi gjeografik, Trajnimi gjyqësor në kohë kritike, Kursi Ndhmës për Konventën MEDICRIME, HELP dhe Bioetika, Liria e shprehjes në kohërat e COVID-19, Refugjatët dhe migracioni, dhe HELP ne kontekstin e aktiviteteve bashkëpunuese.

Ndërsa në ditën e dytë janë trajtuar këto tema: “70 vjet te Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut-KEDNJ”, HELP ne zhvillimin e mëtutjeshëm në 2021 dhe më gjerë, Sesioni Plotësues kushtuar HELP-it në Universitete/ Rrjeti i hapur akademik i Këshillit të Evropës (OCEAN), Bashkëpunimi Akademik në fushën e bioetikës, Bashkëpunimi akademik për aktivitetet antikorrupsion, Seanca Q & A me ambasadorët dhe Konkluzionet.

Gjithashtu në këtë konferencë u trajtuan edhe çështjet e veprimit të Këshillit të Evropës (KE) gjatë kohës së pandemisë, kurset që janë përgatit dhe janë mbajt, udhëzuesit për zbatimin e kurseve të HELP-it. BE është partneri kryesor i KE dhe se ky partneritet duhet të rritet (këto kurse synohen të mbahen edhe në vendet tjera jashtë KE).

Fondi evropian i HELP ka qene unik nga te gjithë anëtarët, ka bashkëpunim edhe me shtetet që nuk janë anëtarë, interesimi është për të vepruar edhe përtej Evropës. Janë adaptuar module për te drejtat e njeriut. Programi i HELP-përmban edhe diversitetin, (KEDNJ dhe nenet e saj trajtohen gjithanshëm ne Programin HELP, kurse te reja për gjyqtare, prokurorë, avokat, mjek, profesionisteve te rinj ligjor. Por ideja shkon edhe përtej botes ligjore.). Kurset dhe trajnimet gjyqësore do te kenë edhe menaxhimin e krizave aktuale pas gjendjes se pandemisë...Synimi bazë është zbatimi i KEDNJ. Është matë efekti i këtyre kurseve-trajnimeve direkt dhe do te lansohen kurse edhe me te avancuara në të ardhmen.

Me dobi të veçantë në këtë konferencë ishte edhe ligjërata e kryetarit të GJEDNJ, z. Robert Spano, i cili veçoi: Bashkëpunimin e GJEDNJ si të shkëlqyeshëm me HELP-in. Sa i përket reformimit ai potencoi se HELP-i ka ndihmuar në të kuptuarit e zbatimit më të mirë të KEDNJ në nivel nacional, Parimi i zbatimit të sundimit të ligjit pa KEDNJ është varke e zbrazet, Pa gjyqtare të pavarur nuk ka zbatim të KEDNJ, Është duke u rritur ndikimi i politikës në gjyqësorin e pavarur. GJEDNJ dhe KEDNJ kane synuar që te krijojnë një kulture. KEDNJ është kulture e Evropës që përmban vlerat si: Sundimin e ligjit, Pavarësinë dhe Paanësinë e gjyqtarit, Te drejtat e njeriut, dhe Lirinë e shprehjes. KEDNJ është e rëndësishme por ne këtë kohe të pandemisë është edhe me e rëndësishme, sepse GJEDNJ do te jete ne vije te pare për mbrojtjen e te drejtave që i garanton KEDNJ. Njëkohësisht adaptimi i ligjeve dhe normave nacionale duhet te jete në pajtim me nenet e KEDNJ.

Ne fund u konkludua se HELP-i dhe shtrirja e projekteve te tij e arsyeton koston. Shume kërkesa qe i drejtohen HELP-it kompetentet pohuan se do të mundohen t'i përgjigjen te gjitha shteteve dhe institucioneve. Mesazh i qarte ishte se KE duhet te ketë transparence me te madhe. Një hap i duhur është te vazhdohet me punën e modelit HELP, përfshire edhe kritikate konstruktive. Për fund u akordua që çdo institucion dhe subjekt të i dërgon

komentet deri ne fund te vitit. E këtë projekt do të përfundohet deri ne fund te vitit. U shprehë një falënderim për te gjithë zyrtarët e HELP-it, profesorët nga akademitë dhe shtetet anëtare dhe ekipin e udhëhequr nga znj.Eva.Pastrana, duke pohuar se do të mirëpritën propozimet që do paraqiten.

Veprimtaria botuese

Takimi i Këshillit të Redaksisë së AD-së

Më 01 korrik 2020, në Akademinë e Drejtësisë është mbajtur takimi i radhës i Këshillit të Redaksisë së Revistave të Akademisë së Drejtësisë.



Qëllimi i këtij takimi ishte përmbledhja e formularëve të vlerësimit për punimet hulumtuese të gjyqtarëve të sapo emëruar të gjeneratës së VII të PTF-së.

Gjatë takimit, Këshilli i Redaksisë diskuton për punimet e gjyqtarëve dhe kriteret për vlerësim sipas formularit i cili rezulton nga Rregullorja e Trajnimit fillestar. Vëmendje të veçantë

kishin kriteret për vlerësim të përcaktuara në formular me ç' rast kishin vërejtjet tek përgjegjësia për vlerësim i cili sipas redaksisë kishte mangësitë e saj. Po ashtu u diskutua edhe mundësia e ofrimit të trajnimit sa i përket hartimit të punimeve hulumtuese i cili do të kontribuonte në përmirësimin e cilësisë së punimeve e më tej edhe në revistën "Justicia".

Në fund të takimit u pajtua që deri me 3 korrik të përfundoj vlerësimi për 37 gjyqtarët e sapo emëruar si dhe raportet nga këto vlerësime ti bashkëngjiten dosjes për përfundimin e Programit të Trajnimit Fillestar.

Në takim përveç anëtarëve të Këshillit të Redaksisë morën pjesë edhe Drejtori Ekzekutiv, Udhëheqësja e Programit për Hulumtime dhe Publikime si dhe Udhëheqësja e Programit të Trajnimit Fillestar të Akademisë së Drejtësisë

Vlerësimi i nevojave trajnuese

Aktivitetet e realizuara për vlerësimin e nevojave trajnuese

Akademia e Drejtësisë me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial i ka ndërtuar dhe zhvilluar mekanizmat për vlerësim të nevojave trajnuese duke i përcaktuar ato qartë në dokumentet e brendshme të saj.

Në Planin e Veprimit për Hartimin e Programit Trajnues për vitin 2021 i ka listuar mekanizmat duke i përcaktuar veprimet, afatet dhe stafin përgjegjës në këtë proces.

Bazuar në këtë plan, Departamenti i PHP-së së bashku me stafin përgjegjës të Akademisë është angazhuar në mbledhjen e informatave nga mekanizmat (burimet) e ndryshëm duke identifikuar vështirësitë në praktikën gjyqësore

dhe çështjet më sfiduese në procesin e bërjes së drejtësisë.

Gjatë muajit korrik janë mbledhë dhe përpunuar të dhënat nga formularët e vlerësimit pas secilit sesion trajnues të mbajtur gjatë vitit 2020 e gjithashtu janë dërguar pyetësorët për vlerësim të nevojave për trajnime në gjykata dhe prokurori.

Në vazhden e vlerësimit të nevojave trajnuese, AD në bashkëpunim me UNDP ka realizuar edhe takime me gjyqtarë dhe prokurorë si dhe me zyrtarë tjerë që merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut për të identifikuar nevojat trajnuese sa i përket mbrojtjes nga diskriminimi.

Takimi me përfaqësues të UNDP-së

Me 07 korrik 2020, Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë së bashku me Udhëheqësen e Programit për Trajnime të Vazhdueshme dhe Programit për Hulumtime dhe Publikime realizuan një takim virtual përmes platformës ZOOM me përfaqësues nga UNDP.

Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi për hapat e më tutjeshëm në zhvillimin e vlerësimit të nevojave trajnuese në fushën e anti diskriminimit, program ky që do të mbështetet nga projekti i UNDP-së.

Me rastin e këtij takimi nga konsulentja e kontraktuar nga UNDP u prezantua koncepti i dokumenti i analizës dhe gjendjes aktuale sa i përket kornizës ligjore vendore që përfshinë anti diskriminimin duke filluar nga Kushtetuta e Kosovës, Gjykata kushtetuese, Ligji për diskriminimin, pastaj në aspektin ndërkombëtar Direktivat e BE-së, Konventa

Evropiane për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut, pastaj edhe mekanizmat tjerë vendorë që janë krijuar në mbrojtje nga diskriminimi me theks të veçantë Ombudspersoni dhe Agjencia për Barazi Gjinore.

Në analizën e legjislacionit ishte përfshirë edhe legjislacioni penal me fokus te krimet e urrejtjes dhe civil, konkretisht ligji për procedurën kontestimore duke vënë në pah pikat kyçe dhe sfidat në zbatim të ligjit sa i përket fushës së anti diskriminimit.

Në fund u pajtua që të hartohet një pyetësor i cili do të kontribuoj vlerësimit të nevojave. Të realizohen takimet me fokus grupet që sipas planit të realizohen në fillim të muajit gusht dhe atë me pjesëmarrës deri në 12 persona e që në kuadër të fokus grupit të përfshihen gjyqtarë nga gjitha nivelet, prokurorë si dhe bashkëpunëtorë profesionalë.

Takim me grupin punues për vlerësimin e nevojave trajnuese në fushën e diskriminimit

Më 27 Korrik 2020, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me UNDP, në funksion të hartimit të programit trajnues për vitin 2021 adekuat me nevojat trajnuese për fushën e diskriminimit, kanë realizuar takimin me grupin e parë punues të cilët vinin nga radhët e zyrës për qeverisje të mirë, zyrtarë nga institucioni i avokatit të popullit, shoqëria civile si dhe nga mediat.

Me rastin e këtij takimi u prezentua korniza ligjore vendore dhe ndërkombëtare në fushën e diskriminimit dhe sfidat dhe problemet praktike në zbatimin e këtij legjislacioni me theks të veçantë të Ligjit mbi diskriminimin dhe Ligjit për barazinë gjinore të Kosovës.

Gjatë diskutimeve u paraqiten problemet me të cilat ballafaqohen institucionet përkatëse në luftën kundër diskriminimit, sfidat e grupeve më të rrezikuara siç janë: fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, etj. Gjithashtu u diskutua edhe rreth lëshimeve dhe hapësirave në Ligjin për mbrojtjen nga Diskriminimi, për përputhjen e ligjit me direktivat e BE-së dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Një nga rekomandimet kryesore ishte që trajnimet në të ardhmen të kenë në fokus

pjesën praktike të luftimit të diskriminimit, pra




me raste praktike në terren, shqyrtimin e Konventës së Stambollit, si dhe rastet e riviktimizimit.

Takimet pritet të vazhdojnë edhe me dy (2) grupe tjera punuese për të përfshirë përfaqësues të ministrive dhe komunave me fokus të zyrtarëve për barazi gjinore dhe zyrtarëve për të drejtat e njeriut si dhe me gjyqtarë, prokurorë dhe bashkëpunëtor profesional në mënyrë që të konsumohen të gjitha burimet e informacionit nga akterët të cilët merren me këtë fushë.



Takimi me përfaqësues të ministrive dhe komunave për vlerësimin e nevojave dhe programit trajnues në fushën e diskriminimit

Më 28 Korrik 2020, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me UNDP, në funksion të hartimit të programit trajnues për vitin 2021 adekuat me nevojat trajnuese për fushën e diskriminimit, përmes platformës ZOOM kanë realizuar takimin e radhës me grupin e dytë punues të cilët vinin nga radhët e ministrive dhe komunave, konkretisht të departamenteve dhe njësive që merren me të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore.



Gjatë këtij takimi në fokus ishte përmbledhja e cila përfshinte kornizën ligjore vendore dhe ndërkombëtare në fushën e diskriminimit dhe mekanizmat institucional në mbrojtje nga diskriminimi, si dhe sfidat dhe problemet praktike në zbatimin e këtij legjislacioni, me theks të veçantë të Ligjit mbi diskriminimin dhe Ligjit për barazinë gjinore të Kosovës.

Gjatë diskutimeve u paraqiten problemet me të cilat ballafaqohen ministrinë dhe komunat me

theks të veçantë zyrtarët për të drejtat e njeriut dhe zyrtarët për barazi gjinore në luftën kundër diskriminimit duke vënë në pah cenimin e të drejtave të fermerëve, bujqve, fëmijëve, të moshuarve dhe grupeve tjera të cenueshme. Gjithashtu u diskutua edhe rreth lëshimeve dhe hapësirave në Ligjin për mbrojtjen nga Diskriminimi, për përputhjen e ligjit me direktivat e BE-së dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Me rastin e këtij takimi nga ky grup dolën rekomandimet për fuqizimin e kapaciteteve të vet zyrtarëve që merren me këtë fushë për të qenë më efikas dhe më funksional në mbrojtjen nga diskriminimi. Më tej u kërkua që pyetësorin për vlerësim të nevojave trajnuese dhe zhvillimit të kurrikulës trajnuese ta plotësojnë dhe ta dërgojnë me tematikën konkrete bazuar në rastet më të shpeshta të diskriminimit që i hasin në praktikë.

Në vazhden e takimeve për vlerësim të nevojave trajnuese dhe zhvillimit të kurrikulës trajnuese për mbrojtjen nga diskriminimi pritet të realizohet edhe me grupin e gjyqtarëve, prokurorëve dhe bashkëpunëtorëve profesional në mënyrë që të konsumohen të gjitha burimet e informacionit dhe akterët të cilët merren me këtë fushë.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve Fillestare

Aktivitetet e realizuara në kuadër të trajnimit fillestar për prokurorët e sapo emëruar

Gjatë muajit korrik prokurorët e sapo emëruar kanë vazhduar me realizimin e trajnimit teorik. Ky trajnim është realizuar në formë virtuale përmes platformës online “Zoom”.

Sipas kalendarit trajnues nga moduli: “Legjislacioni dhe shkathhtësitë plotësuese” janë realizuar tri (3) sesione trajnuese nga nën moduli: Hetimi i Krimin ndërkufitar si dhe nga moduli: “Rendi Juridik kombëtar dhe ndërkombëtar” janë realizuar dy (2) sesione trajnuese për KEDNJ.


Në kuadër të nën modulit: “Hetimi i krimin ndërkufitar” janë trajtuar: faktorët e paraqitjes së krimin ndërkufitarë, mënyrat dhe parandalimi i hetimit të krimin ndërkufitarë.

Nga nën moduli: “KEDNJ” pjesëmarrësit patën mundësinë të zbërthejnë dispozitat e nenit 13 të KEDNJ-së që kanë të bëjnë me ndalimin e diskriminimit dhe protokollin 12 i KEDNJ dhe diskriminimi.

Me 27 dhe 28 korrik 2020 Prokurorët e sapo emëruar të kësaj gjenerate kanë mbajtur testin përfundimtar.

Sa i përket sesioneve nga trajnimi praktik, gjatë këtij muaji ashtu siç është paraparë me programin trajnues janë realizuar 12 ditë.

Trajnimitin fillestar e kanë ndjekur 12 prokurorë të sapo emëruar gjenerata e (VIII).



Testi përfundimtar për prokurorët e sapo emëruar (gjenerata e tetë) 2019-2020

Me 27 dhe 28 korrik 2020, bazuar në Programin e Trajnimit Fillestar dhe kërkesave që dalin nga ky program me rastin e përfundimit të moduleve trajnuese, prokurorët e sapo emëruar i janë nënshtruar testit përfundimtar konform Rregullores për Trajnim Fillestar.



Testi përfundimtar është realizuar në dy pjesë për pesë module trajnuese si në vijim: “Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar”, “Shkathtësitë personale dhe ndër personale”, “Kodi Penal”, Kodi i Procedurës Penale, dhe “Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese”.

Në ditën e parë prokurorët i janë nënshtruar testimit nga moduli “Rendit Juridik Kombëtar dhe Ndërkombëtar” si dhe “Kodit Penal”, ndërsa ditën e dytë, testi është zhvilluar për modulin: “Kodi i Procedurës Penale”, “Shkathtësitë personale dhe ndërdisiplinore”, dhe në fushat tjera nga moduli “Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese”.

Procesi i testimit të prokurorëve të sapo emëruar është monitoruar nga Udhëheqësja e Trajnimit Fillestar znj. Valmira Pefqeli, dhe stafi i AD-së.



Aktivitetet e realizuara në PTF të prezantuara përmes grafikoneve



Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

Trajnimi: Marrja në pyetje e dëmtuarit ne rastet e veprave penale kundër integritetit seksual

Më 01 dhe 02 Korrik 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, ka realizuar trajnimin me temë “Marrja në pyetje e dëmtuarit ne rastet e veprave penale kundër integritetit seksual”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive profesionale të pjesëmarrësve me dispozitat ligjore lidhur me rastet kur fëmijët janë viktimë e veprës penale kundër integritetit seksual.


Gjatë këtij trajnimi virtual në platformën Zoom nga trajnuesit u trajtuan parimet e përgjithshme që duhet respektuar kur kemi të bëjmë me viktimën fëmije si pasojë e veprës penale kundër integritetit seksual me theks të veçante marrja në pyetje, teknikat dhe taktikat. Në vijim u trajtuan veprimet procedurale të cilat ndërmerren kur kemi të bëjmë me viktimën fëmijë dhe mbështetja që duhet bërë për fëmijët

viktimia sipas dispozitave ligjore dhe të akteve ndërkombëtare nga të gjitha organet shtetërore.

Me rastin e këtij trajnimi u vu në pah që fëmijët -viktimia të veprave penale kanë nevojë për mbrojtje të posaçme, për asistencë dhe mbështetje e cila përputhet me moshën e tyre, pjekurinë dhe nevojat e posaçme individuale, me qëllim që të pengohet riviktimizimi i mëtejshëm si rezultat i pjesëmarrjes në procesin e gjyqësisë penale.

Metodologjia e trajnimit është bazuar në diskutime interaktive duke shtjelluar edhe raste të ndryshme nga praktika gjyqësore.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: Gjyqtar nga Gjykata e Apelit, gjyqtar dhe prokuror nga niveli Themelor nga gjitha regjionet e Kosovës.



Trajnimi: Mbrojtja gjyqësore në kontestet nga marrëdhënia e punës sipas Ligjit të Punës

Më 08-09 Korrik 2020, Akademia e Drejtësisë organizoj trajnimin me temë: “Mbrojtja gjyqësore në kontestet nga marrëdhënia e punës sipas Ligjit të Punës” në kuadër të PTV-së. Në rrethanat e krijuara të pandemisë COVID 19 edhe ky trajnim u mbajt virtualisht përmes platformës elektronike Zoom. Trajnimi u zhvillua direkt/live për dy ditë, dita I me 08.07.2020 nga ora 13:00-15:30 dhe dita II me 09.07.2020 nga ora 13:00-15:30.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me kontestet nga marrëdhënia e punës sipas legjislacionit në fuqi të punës në Republikën e Kosovës

Në të dy ditët e trajnimit u trajtuan temat në vijim: Kontratat e punës dhe llojet e tyre, Kontestet nga marrëdhënia e punës sipas ligjit të punës, Procedura gjyqësore për mbrojtjen e të drejtave të punës si dhe Respektimi i afateve për të kërkuar mbrojtje gjyqësore.


Në trajnim u theksua se Ligji i Punës rregullon të drejtat dhe detyrimet në mes të punëdhënësit dhe punëmarrësit, si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik në Republikën e Kosovës, si dhe për të punësuarit dhe punëdhënësit, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë, nëse ligji i veçantë nuk parashikon

zgjdhje për çështje të caktuara të punës.

Gjithashtu u potencuan shkaqet e shpëputjes së kontratës së punës, procedurën gjyqësore që zhvillohet tek kontestet e punës sipas Ligjit të Punës, llojet e vendimeve gjyqësore që merren tek kontestet e punës, dallimet në mes të kontesteve për shërbyesit civil dhe kontesteve tjera nga marrëdhënia e punës, procedurat e brendshme të cilat duhet ti shfrytëzojnë shërbyesit civil para se të kërkojnë mbrojtje gjyqësore, e drejta e kërimit të mbrojtjes gjyqësore, kompetencën, afatet, pasojat juridike në rast të mos respektimit të afateve për të kërkuar mbrojtje gjyqësore sipas legjislacionit në fuqi tek kontestet e punës, mjetet juridike etj.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike, të përcjella me shembuj nga praktika gjyqësore dhe diskutime për mënyrën e vendosjes meritorë për rastet konkrete.

Përfitues në këtë trajnim ishin Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit, gjykatave themelore si dhe avokatë shtetëror.



Trajnimi: Falimentimi

Më 09-10 korrik 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të PTV-së në bashkëpunim me projektin IFC/Grupi i Bankës Botërore organizoj trajnimin me temë “Falimentimi”. Ky trajnim u mbajt virtualisht direkt/live për dy ditë përmes platformës elektronike Zoom, Dita I me 09.07.2020 nga ora 13:00-17:30 dhe dita II me 10.07.2020 nga ora 13:00-17:30.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte ngritja e ekspertizës profesionale të gjyqtareve dhe krijimi i praktikës gjyqësore në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe përvojat e praktikave më të mira të shteteve në rajon të zbatimit të instrumenteve ndërkombëtare që rregullojnë këtë fushë.


Në dy ditët e trajnimit u trajtuan temat në vijim: Përkeqësimi financiar dhe paaftësia paguese, Parimet e bankës botërore dhe standardet ndërkombëtare, Këndvështrimi i përgjithshëm i Ligjit të falimentimit në Kosovë, COVID-19 dhe falimentimi, Shpëtimi i firmave të vlefshme, Roli i gjykatës në Ligjin e falimentimit në Kosovë si dhe roli i administratorit në Ligjin e Falimentimit në Kosovë.

Në trajnim u theksua se Ligji për Falimentimin rregullon procedurat e likuidimit dhe riorganizimit të të gjitha shoqërive tregtare, duke përfshirë edhe bizneset individuale, ortakëritë e përgjithshme, dhe ortakëritë e kufizuara, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara ose shoqëritë aksionare.

Gjithashtu u potencuan specifikat e hapjes së rastit të falimentimit, procedurat ligjore, afatet dhe vendimet e gjykatës e me theks të veçantë kërkesat e kreditorëve, mënyrat e paraqitjes, afatet dhe prioritetet e kërkesave.

Gjatë këtij trajnimi nga trajnues vendor dhe ndërkombëtar u përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike, të përcjella me shembuj nga praktika gjyqësore dhe diskutime për mënyrën e vendosjes meritorë për rastet konkrete.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: Gjyqtar nga niveli Themelor dhe Apelit, Prokuror nga niveli Themelor, Bashkëpunëtor profesional, Zyrtar ligjor dhe Zyrtar për ndihmë juridike falas.



Program i Specializuar: Krimi i organizuar dhe korrupsioni- Sesioni II


Më 13 -14 korrik 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, organizoi sesionin e trajnimit me temën “Program i Specializuar Trajnimi - Krimi i organizuar dhe korrupsioni- Sesioni II”. Qëllimi i këtij trajnimi ishte ngritja e kapaciteteve profesionale e gjyqtarëve, prokurorëve dhe përfituesve tjerë për format e krimit të organizuar dhe veprave tjera penale të ndërlidhura me korrupsionin dhe zbatimi i drejtë i procedurave dhe dispozitave përkatëse.

Gjatë këtij trajnimi On-line në platformën Zoom nga trajnuesit u trajtua vepra penale e krimit të organizuar dhe veprat penale që ndërlidhen me të, si dhe korrupsioni sipas legjislacionit penal në fuqi, pasojat e korrupsionit si dhe format e bashkëpunimit dhe koordinimit institucional të institucioneve të mandatuara për luftën kundër korrupsionit.

Po ashtu gjate trajnimit u elaboruan instrumentet vendore dhe ndërkombëtare në luftën kundër korrupsionit, dilemat dhe vështirësitë e të provuarit të veprave të natyrës korruptive si dhe masat për parandalimin dhe ekspozimin ndaj korrupsionit zyrtarë. Në vazhdim u trajtuan edhe hetimi dhe sigurimi i provave në rastet e krimit të organizuar, hetimi dhe sigurimi i provave në rastet e korrupsionit

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive si dhe përmes rasteve praktike ku pjesëmarrësit kishin mundësinë të paraqesin sfidat dhe vështirësitë praktike.

Përfitues të trajnimit ishin gjyqtarë, prokurorë të nivelit të Apelit dhe themelor të regjioneve të ndryshme të Kosovës.



Trajnimi: Trafikimi me qenie njerëzore dhe kontrabandimi me migrantë

Më 15-16 Korrik 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme (PTV) organizoi trajnimin me temë “Trafikimi i qenieve njerëzore dhe kontrabandimi me migrantë”. Ky trajnim u mbajt virtualisht përmes platformës elektronike Zoom Pro. Trajnimi u zhvillua direkt/live për dy ditë, dita I me 15.07.2020 nga ora 13:00-15:30 dhe dita II me 16.07.2020 nga ora 13:00-15:30.


Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve, rreth zbatimit të drejtë të legjislacionit lidhur me trafikimin me njerëz dhe identifikimit të elementeve të veprës penale të trafikimit me njerëz.

Gjatë trajnimit u trajtuan kuptimi dhe elementet e trafikimit të qenieve njerëzore, veprat penale të ndërlidhura me trafikimin e

qenieve njerëzore, të drejtat e viktimave të trafikuar gjatë procedurës penale. Me theks të veçantë u trajtua mbrojtja dhe asistimi i viktimave të trafikimit, përforcimi i bashkëpunimit dhe koordinimi mes akterëve kyç, si dhe kompensimi i viktimave të trafikimit.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike, të përcjella me shembuj nga praktika gjyqësore dhe diskutime për mënyrën e vendosjes meritorë për rastet konkrete.

Përfitues në këtë trajnim ishin Gjyqtar dhe Prokuror nga niveli i Apelit dhe Themelor.



Program i Specializuar: Krimi kibernetik, provat elektronike-sesioni II

Më 28-29 korrik 2020, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme (PTV) ka realizuar Sesionin e dytë të trajnimit “Krimi kibernetik, provat elektronike”.


Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve dhe përfituesve tjerë që të kuptojnë natyrën dhe implikimet dëshmuese të çështjeve të krimit kibernetik dhe të kontrollit, sekuestrimit dhe konfiskimit të të ardhurave të krimit online, si edhe instrumentet e disponueshme ligjore dhe qasjet ndaj bashkëpunimit ndërkombëtar.

Gjatë këtij trajnimi On-line në platformën Zoom u trajtua Konventa e Budapestit për Krimin Kibernetik dhe akte tjera ndërkombëtare duke i përfshirë edhe dispozitat ligjore të brendshme që sanksionojnë krimin kibernetikë. Vëmendje parësore iu kushtua



provave elektronike dhe të ardhurat e krimit kibernetik të cilat janë komplekse dhe për të qenë të suksesshëm duhet një bashkëpunim i të gjitha institucioneve relevante të brendshme dhe ndërkombëtare si dhe ekspertëve të fushave të përkatëse për t'i hetuar dhe ndëshkuar këto krime të cilat çdo ditë e më tepër janë në rritje.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive, ku pjesëmarrësit kishin mundësinë të paraqesin sfidat dhe vështirësitë që ballafaqohen në praktikë.


Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët nga niveli i Apelit dhe themelorë, prokurorë nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit dhe prokurorë nga niveli themelorë.



Vijueshmëria në trajnime në PTV e prezantuar përmes grafikoneve



Numri i pjesëmarrjes në trajnime në bazë të Institucioneve
Korrik 2020



Pjesë marrja sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike Korrik 2020



Kurset e mësimit në distancë-Elearning

Gjatë muajit korrik, platforma e mësimit në distancë ka vazhduar të jetë e hapur për pjesëmarrësit e interesuar (Gjyqtarë, Prokurorë, staf administrativ i gjykatave dhe prokurorive si dhe për studentët e Fakulteteve Juridike) pa afat të caktuar kohor.

Në kuadrin e kësaj platforme janë 18 kurse të çashtme online, 7 prej të cilave edhe në gjuhën serbe.

Më 20 korrik 2020, sipas Rregullores së Këshillit Gjyqësor të Kosovës (Nr. 06/2019) për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (Nr. 06/2017) është lëshuar online edhe kursi obligativ “Etika profesionale” për gjyqtarët e Republikës së Kosovës.

Për në detaje janë tabelat të cilat prezantojnë vijueshmërinë dhe progresin në ndjekjen e kurseve sipas temës në këtë platformë.

| Emri i Kursit | Kompletimi i Kursit | Përqindja | Në Progres | Përqindja | Nuk kanë filluar fare | Përqindja |
|--|---------------------|-----------|------------|-----------|-----------------------|-----------|
| <i>(Etika Profesionale) Procedura dhe përgjegjësia disiplinore (Shqip)</i> | 93 | 62% | 30 | 20% | 27 | 18% |
| <i>Etika Profesionale I</i> | | | | | | |
| <i>Etika Profesionale II</i> | 113 | 75% | 13 | 9% | 24 | 16% |

| Emri i Kursit | Kompletimi i Kursit | Përqindja | Në Progres | Përqindja | Nuk kanë filluar fare | Përqindja |
|---|---------------------|-----------|------------|-----------|-----------------------|-----------|
| <i>(Etika Profesionale) Procedura dhe përgjegjësia disiplinore (Serbisht)</i> | 10 | 7% | 16 | 11% | 124 | 83% |
| <i>Etika Profesionale I (Serbisht)</i> | 11 | 7% | 54 | 36% | 85 | 57% |
| <i>Etika Profesionale II (Serbisht)</i> | 11 | 7% | 33 | 22% | 106 | 71% |

| Emri i Kursit | Kompletimi i Kursit | Përqindja | Në Progres | Përqindja | Nuk kanë filluar fare | Përqindja |
|-----------------------------|---------------------|-----------|------------|-----------|-----------------------|-----------|
| <i>Masat e Diversitetit</i> | 3 | 3% | 8 | 8% | 89 | 89% |

| Emri i Kursit | Kompletimi i Kursit | Përqindja | Në Progres | Përqindja | Nuk kanë filluar fare | Përqindja |
|--------------------------|---------------------|-----------|------------|-----------|-----------------------|-----------|
| <i>Menaxhimi Efektiv</i> | 3 | 18% | 12 | 71% | 2 | 12% |

| Emri i Kursit | Kompletimi i Kursit | Përqindja | Në Progres | Përqindja | Nuk kanë filluar fare | Përqindja |
|---|---------------------|-----------|------------|-----------|-----------------------|-----------|
| <i>Drejtësia për fëmijë aspekti Civil</i> | 16 | 16% | 19 | 19% | 65 | 65% |

| Emri i Kursit | Kompletimi i Kursit | Përqindja | Në Progres | Përqindja | Nuk kanë filluar fare | Përqindja |
|---|---------------------|-----------|------------|-----------|-----------------------|-----------|
| <i>Drejtësia për fëmijë aspekti Penal</i> | 10 | 10% | 15 | 15% | 75 | 75% |

| Emri i Kursit | Kompletimi i Kursit | Përqindja | Në Progres | Përqindja | Nuk kanë filluar fare | Përqindja |
|--|---------------------|-----------|------------|-----------|-----------------------|-----------|
| <i>Hetimi dhe zbulimi i Korrupsionit</i> | 11 | 11% | 10 | 10% | 79 | 79% |

| Emri i Kursit | Kompletimi i Kursit | Përqindja | Në Progres | Përqindja | Nuk kanë filluar fare | Përqindja |
|---|---------------------|-----------|------------|-----------|-----------------------|-----------|
| <i>Korrupsioni sipas legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar</i> | 7 | 7% | 7 | 7% | 86 | 86% |
| Emri i Kursit | Kompletimi i Kursit | Përqindja | Në Progres | Përqindja | Nuk kanë filluar fare | Përqindja |
| <i>Menaxhimi i Gjykatës</i> | 13 | 13% | 6 | 6% | 81 | 81% |

| Emri i Kursit | Kompletimi i Kursit | Përqindja | Në Progres | Përqindja | Nuk kanë filluar fare | Përqindja |
|---------------------------------|---------------------|-----------|------------|-----------|-----------------------|-----------|
| <i>Udhëheqësia - Lidershipi</i> | 11 | 11% | 9 | 9% | 80 | 80% |

| Emri i Kursit | Kompletimi i Kursit | Përqindja | Në Progres | Përqindja | Nuk kanë filluar fare | Përqindja |
|--|---------------------|-----------|------------|-----------|-----------------------|-----------|
| <i>E drejta e autorit dhe mbrojtja juridike (Shqip)</i> | 8 | 8% | 18 | 18% | 74 | 74% |
| <i>E drejta e autorit dhe mbrojtja juridike (Serbisht)</i> | 2 | 22% | 3 | 33% | 4 | 44% |

| Emri i Kursit | Kompletimi i Kursit | Përqindja | Në Progres | Përqindja | Nuk kanë filluar fare | Përqindja |
|--|---------------------|-----------|------------|-----------|-----------------------|-----------|
| <i>Faza e aktakuzës dhe deklarimit për Fajësinë (Shqip)</i> | 19 | 19% | 14 | 14% | 67 | 67% |
| <i>Faza e aktakuzës dhe deklarimit për Fajësinë (Serbisht)</i> | 2 | 22% | 3 | 33% | 4 | 44% |

| Emri i Kursit | Kompletimi i Kursit | Përqindja | Në Progres | Përqindja | Nuk kanë filluar fare | Përqindja |
|---------------------------------------|---------------------|-----------|------------|-----------|-----------------------|-----------|
| <i>Menaxhimi i stresit (Shqip)</i> | 36 | 36% | 18 | 18% | 46 | 46% |
| <i>Menaxhimi i stresit (Serbisht)</i> | 6 | 67% | 3 | 33% | 0 | 0% |

| Emri i Kursit | Kompletimi i Kursit | Përqindja | Në Progres | Përqindja | Nuk kanë filluar fare | Përqindja |
|--|---------------------|-----------|------------|-----------|-----------------------|-----------|
| <i>Shkathësitë e komunikimit social (Shqip)</i> | 8 | 8% | 8 | 8% | 84 | 84% |
| <i>Shkathësitë e komunikimit social (Serbisht)</i> | 2 | 22% | 3 | 33% | 4 | 44% |


| Emri i Kursit | Kompletimi i Kursit | Përqindja | Në Progres | Përqindja | Nuk kanë filluar fare | Përqindja |
|--|---------------------|-----------|------------|-----------|-----------------------|-----------|
| <i>Trajnimi për implementimin e legjislacionit tati-mor në Kosovë (Shqip)</i> | 7 | 7% | 6 | 6% | 87 | 87% |
| <i>Trajnimi për implementimin e legjislacionit tati-mor në Kosovë (Serbisht)</i> | 1 | 11% | 3 | 33% | 56 | 56% |

| Emri i Kursit | Kompletimi i Kursit | Përqindja | Në Progres | Përqindja | Nuk kanë filluar fare | Përqindja |
|---|---------------------|-----------|------------|-----------|-----------------------|-----------|
| <i>Komunikimi dhe marrëdhëniet me publikun (Shqip)</i> | 12 | 12% | 35 | 35% | 53 | 53% |
| <i>Komunikimi dhe marrëdhëniet me publikun (Serbisht)</i> | 1 | 11% | 4 | 44% | 4 | 44% |

| Emri i Kursit | Kompletimi i Kursit | Përqindja | Në Progres | Përqindja | Nuk kanë filluar fare | Përqindja |
|---------------------------|---------------------|-----------|------------|-----------|-----------------------|-----------|
| <i>Anglishtja Ligjore</i> | 37 | 37% | 21 | 21% | 42 | 42% |

| Emri i Kursit | Kompletimi i Kursit | Përqindja | Në Progres | Përqindja | Nuk kanë filluar fare | Përqindja |
|--------------------------------|---------------------|-----------|------------|-----------|-----------------------|-----------|
| <i>Teknologjia Informative</i> | 31 | 31% | 12 | 12% | 57 | 57% |

| Emri i Kursit | Kompletimi i Kursit | Përqindja | Në Progres | Përqindja | Nuk kanë filluar fare | Përqindja |
|------------------------------------|---------------------|-----------|------------|-----------|-----------------------|-----------|
| <i>Dhuna në Familje (Shqip)</i> | 0 | 0% | 10 | 77% | 3 | 23% |
| <i>Dhuna në Familje (Serbisht)</i> | 0 | 0% | 3 | 23% | 10 | 77% |



Adresa “Lagjja e Spitalit”
Rr. Muharrem Fejza p.n
Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: + 383 38 200 18 660
E-mail: infoad@rks-gov.net
<https://ad.rks-gov.net>